



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

---

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.02.2021, merr këtë

#### V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bejtush Gashit.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 1794-21, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-01794-21, Zona kadastrale Prishtinë, me destinim sipas Planit rregullues “Prishtina e re - Zona Perëndim”, i miratuar sipas Vendimit, nr. 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesë e parcelës kadastrale nr. 1794-33, Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01794-33, në pronësi të Bejtush Gashit, e hipotekuar në favor të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., Prishtinë, për të cilën Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., Prishtinë, ka dhënë pëlqimin për lidhjen e Marrëveshjes së këmbimit me Komunën e Prishtinës, për këmbimin e pjesëve të parcelave nr. 1794-32 dhe 1794-33, me sipërfaqe prej 1564 m<sup>2</sup>, me destinim sipas Planit rregullues “Prishtina e re - Zona Perëndim”, i miratuar sipas Vendimit, nr. 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim”, i miratuar sipas Vendimit, nr. 01 nr. 35-186850, dt. 02.10.2013.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.

- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
  - kopjet e planit,
  - certifikatat e njësisë kadastrale dhe
  - Pëlqimi nga Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., Prishtinë.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-463/01-27273/21, më 11.02.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta



## A r s y e t i m

Drejtoria e Urbanizmit me Vendimin për miratimin e kërkesës nr. 05, nr. 350/03-131425/19, dt. 07.06.2019, për rishqyrtimin e Vendimit nr. 05, nr. 350/02-0264680/18, dt. 29.11.2018, mbi refuzimin e kërkesës për Kushte ndërtimore, nr. 05, nr. 350/02-0264680/18, dt. 02.11.2018, shfuqizimin e Vendimit refuzues dhe caktimin e kushteve ndërtimore, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale, nr. 1794-21, në pronësi PSH të KK Prishtinë, Planit rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim”, i miratuar sipas Vendimit, nr. 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, me parcelën kadastrale nr. 1794-33, ZK Prishtinë, në pronësi të Bejtush Gashit, e hipotekuar në favor të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., Prishtinë, për të cilën Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., Prishtinë, më 28. janar 2021, ka dhënë pëlqimin për lidhjen e Marrëveshjes së këmbimit me Komunën e Prishtinës, për këmbimin e pjesëve të parcelave nr. 1794-32 dhe 1794-33, me sipërfaqe prej 1567 m<sup>2</sup>, të cilat gjenden në kuadër të Planit rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim”, i miratuar sipas Vendimit, nr. 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013. Propozimi për iniciimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim”, i miratuar sipas Vendimit nr. 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, me destinim “Zonë mix ndërtimi” të Planit rregullues “Prishtina e Re - Zona “Perëndim”, miratuar sipas Vendimit 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, parcela kadastrale nr.1794-21, shtrihen në zonë të planifikuar për ndërtim të lartë, ndërsa parcela nr.1794-33, shtrihet në infrastrukturë rrugore të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), pasi Komuna nuk ka pronë të vetën për implementimin e projekteve të lartcekura.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij Propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.